



Financuar nga
Bashkimi Evropian


Qendra për
transparencë
dhe informim
qTIL të lirë

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

2025

GUIDË E HARTIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT NË ORGANET E DREJTËSISË

Qendra për Transparencë dhe
Informim të Lirë (qTIL)



PUBLIKUESI:**Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë****Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal. 2, Sh. 2,
Tirana, Albania****Tel: +355 682088602****E-mail: info@transparence.al****Web: www.transparence.al**

VITI I PUBLIKIMIT:**2025**

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë (qTIL) dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (qTIL).



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PARATHËNIE	03
Çfarë është buxheti	04
Kuadri ligjor që ndjek procesin e hartimit të buxhetit në institucionet publike (përfshirë edhe institucionet e pavarura)	06
Kuadri ligjor për monitorimin e zbatimit të buxhetit	06
Përfshirja e Institucioneve	09
Fazat e procesit buxhetor	09
Çfarë duhet ditur për përgatitjen dhe miratimin e buxhetit të Sistemit të Drejtësisë	12
Programi i Buxhetit të sistemit të Drejtësisë	14
Detajimi i buxhetit të Drejtësisë	15
Hartimi i Programit të Buxhetit Afatmesëm për Drejtësinë	18
Monitorimi i zbatimit të buxhetit	19
• Monitorimi i zbatimit të buxhetit sipas ligjit për “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” • Monitorimi i zbatimit të buxhetit sipas Udhëzimit nr. 22/2016 i Ministrisë së Financave (ndryshuar me udhëzimin nr.14/2023)	19 20
RAST PRAKTIK - Ku gjenden të dhënat financiare për buxhetin e drejtësisë?	24

PARATHËNIE

Ky udhërrëfyes synon të ndihmojë aktorët kryesorë të sistemit të Drejtësisë, përfshirë magjistratët (gjyqtarët, prokurorët dhe stafin jo-gjyqësor të sistemit), por edhe gazetarët dhe të gjithë shoqërinë, për të kuptuar procesin e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit.

Gjykatësit dhe prokurorët, ashtu si edhe aktorë të tjerë, kanë pasur deri tani pak njohuri mbi buxhetin e sistemit të tyre, madje edhe të njësisë së cilës i përkasin, pavarësisht raportimeve periodike nga punonjësit e financës të njësive përkatëse[1].

Kjo mungesë e njohurive themelore për buxhetin dhe për lobimin për sigurimin e shtesës së fondeve jetike, veçanërisht për investimet themelore dhe të domosdoshme, i ka mbajtur magjistratët dhe opinionin publik larg procesit të përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të buxhetit të sistemit të Drejtësisë.

Kjo distancë ka krijuar dhe vazhdon të krijojë një lloj indiferentizmi midis magjistratëve, të cilët shpesh justifikohen me deklaratat e tilla si: "Nuk i dimë mirë çështjet e buxhetit", "Nuk kemi kohë të mjaftueshme për t'u marrë me çështjet e buxhetit", ose "Nuk kemi asnjë ndikim, gjithçka vendoset nga Ministria e Financave dhe qeveria".

Në të vërtetë, duke qenë aktorët kryesorë të sistemit të Drejtësisë, ata duhet të jenë lobuesit e parë pranë qeverisë, Kuvendit dhe shoqërisë, së bashku me gazetarët, për t'u siguruar që buxheti i sistemit të tyre të marrë fondet e duhura. Sidomos për investimet themelore, që janë jetike për ndërtimin e një sistemi drejtësie të ri, më efektiv dhe më efikas.

[1] 2023 Analytical report on budget and expenses in the justice system p 10.11, CTFI, 2024

ÇFARË ËSHTË BUXHETI

Fjala buxhet e ka prejardhjen nga fjala frëngjisht buzhet (bougette), e cila rrjedh nga fjala buz (bouge), që do të thotë një çantë lëkure.

Në mesjetë, përpara Parlamentit anglez, prezantoheshin disa letra, të cilat përmbanin informacion rreth taksave dhe shpenzimeve. Këto letra futeshin në çanta të vogla lëkure (bougette), të cilat vendoseshin mbi një tavolinë përpara asamblesë.

“fond buxhetor” - shumë parash që përdoret për një qëllim të caktuar, në formë shpenzimi.

“shpenzim buxhetor” - shumë parash që shpenzohet plotësisht për një qëllim të caktuar, brenda vitit buxhetor.

“buxheti për banor” - raporti i totalit të buxhetit të sistemit të Drejtësisë mbi popullsinë e Shqipërisë. Për vitin 2024, ky tregues ishte 21.6 euro për banor.

“Programi buxhetor” - përfaqëson tërësinë e fondeve të dedikuara buxhetore për një strukturë kryesore të sistemit të Drejtësisë.

“përqindja e realizimit të shpenzimeve” - kur në një raport të buxhetit cilësohet, për shembull, se shpenzimet për investime u realizuan në vitin 2023 në masën 30 përqind, kjo nënkupton se fondi përkatës është shpenzuar vetëm në 3 të dhjetat e tij.





“shpenzime operative” - shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera, si karburanti i automjeteve të institucionit të Drejtësisë, shpenzimi i printimit të dokumenteve, etj.

“shpenzime korente” - shpenzimet për pagat, për sigurimet shoqërore, si dhe shpenzimet për mallrat dhe shërbime të tjera.

“fond i çelur” - fond, përdorimi i të cilit gjatë një viti buxhetor është miratuar nga Dega e Thesarit dhe ndodhet në llogarinë e institucionit gati për t’u përdorur.

“fond i djegur” - fond i papërdorur, i cili nuk u arrit të përdoret gjatë vitit të dhënë buxhetor, si dhe nuk mund të mbartet ose të përdoret si fond shtesë për vitin e ardhshëm buxhetor.

“fond i çelur i ngrirë” - fond i cili është hapur nga Dega e Thesarit, por që për një arsye ose tjetër, nuk mund të përdoret gjatë vitit buxhetor.

Kuadri ligjor që ndjek procesin e hartimit të buxhetit në institucionet publike (përfshirë edhe institucionet e pavarura)

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila përkufizon nevojën që ligjet dhe rregulloret që ndjekin procesin e buxhetimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e kushtetutës.
- Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor rregullon sistemin buxhetor, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi në të gjitha fazat e procesit buxhetor.
- Ligji për buxhetin vjetor miratohet çdo vit nga Kuvendi dhe vendos për shumat e të ardhurave dhe shpenzimeve, apo linjat e buxhetit të një viti.
- Vendime nga Këshilli i Ministrave ku pasqyrohen drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore për buxhetin.
- Udhëzime e urdhëra nga Ministria e Financave që është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të buxhetit publik.

Kuadri ligjor për monitorimin e zbatimit të buxhetit

Kuadri ligjor në Shqipëri është si në vijim:

Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar; Ky ligj zbatohet nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në të gjitha fazat e procesit buxhetor, që do të thotë:

- përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit;
- zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit;
- të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë, si dhe format e tjera, të rrjedhura prej tyre;
- kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin e buxhetit[2]

[2] <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligj-nr.-9936-date-26.06.2008-Per-menaxhimin-e-sistemit-buxhetor-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf>. Ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012, ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, me aktin normativ nr. 27, datë 1.7.20201 : me aktin normativ nr. 25, datë 22.6.2012. Neni 2

- Ligji nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë[3].
- Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"[4]. Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike; b) shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; c) njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit":[5] (Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike).
- Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"[6]. (Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij).

Si kuadri ligjor për hartimin e buxhetit edhe ai për monitorimin e tij përveçse kryqëzohen së bashku në funksionet e tyre sigurojnë edhe zbatimin e parimeve të buxhetimit:

- Gjithëpërfshirja e cila siguron përfshirjen e të gjitha operacioneve fiskale, si nga krahu i të ardhurave ashtu edhe nga ai i shpenzimeve.
- Parashikueshmëria që siguron se buxheti duhet të jetë i parashikueshëm në periudhë afatmesme në mënyrë që tu mundësojë aktorëve ekonomikë planifikim sa më të saktë të prodhimit apo shërbimeve.
- Transparenca që siguron se buxheti duhet të jetë i hapur për të gjithë dhe ndërkaq përfshin një numër të madh të grupeve të interesit apo publikut në hartimin dhe ndarjen e tij.
- Përfaqësimi që siguron se buxheti duhet të përfaqësojë të gjitha grupet e interesit dhe të ketë një trajtim të barazisë gjinore.
- Kuptueshmëria që siguron se informacioni që jepet nga buxheti duhet të kuptohet lehtë.

[3] Ligj Nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 dhe ligjin nr. 14/2023. Neni 2

[4] <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2024/03/Ligji-Nr.114-date-22.10.2015-Per-auditimin-e-brendshem-ne-Sektorin-Publik.pdf>. ndryshuar me ligj nr. 12, datë 2.02.2023 "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Neni 2

[5] Ligj nr. 119/2014 për të drejtën e informimit (i ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"). Neni 2

[6] Ligj nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Neni 2



Kuadri ligjor për monitorimin e zbatimit të buxhetit

Rregullon procesin e monitorimit dhe siguron përdorimin e duhur të fondeve publike

**Ligji nr.
9936/2008**

Përmban rregulla për përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe auditimin e buxhetit.



Përcakton detyrimet e njërive publike për auditimin e brendshëm.

**Ligji nr.
114/2015**

**Ligji nr.
10296/2010**

Siguron efikasitetin, transparencën dhe ligjshmërinë në menaxhimin e financave publike.



Siguron informimin e publikut mbi informacionin që prodhohet nga autoritetet publike.

**Ligji nr.
119/2014**

**Ligji nr.
154/2014**

Synon auditimin dhe mbikëqyrjen e financave publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.



Përfshirja e Institucioneve

Në bazë të piramidës së hartimit të buxhetit janë institucionet ose ndryshe njësitë e qeverisjes qendrore ku hyjnë edhe institucionet e drejtësisë. Njësitë e qeverisjes qendrore janë ministrinë, institucionet parlamentare dhe Kushtetuese dhe në rastin e Drejtësisë janë Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Komisioni i Pavarur i Apelit (KPA), Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion (SPAK) dhe Gjykata Kushtetuese.

Njësitë e qeverisjes qendrore (edhe institucionet e drejtësisë) e dërgojnë buxhetin e tyre në Ministrinë e Financave për miratim. Më pas kjo ministri e kalon në Këshillin e Ministrave. Këshilli i Ministrave miraton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe i propozon Kuvendit ligjin e buxhetit vjetor.

Segmenti i tretë i këtij vargu është kalimi i buxhetit nga qeveria në Kuvend ku ai aprovohet. Roli i Kuvendit është miratimi i fondeve buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes qendrore.

Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin efektiv të buxhetit nga institucionet publike.

Fazat e procesit buxhetor

Fazat e procesit buxhetor përbëjnë gjithë ciklin nëpër të cilin lëviz një buxhet vjetor që nga planifikimi deri në kontrollin e zbatimit të tij. Praktikisht ky cikël përfshin 2 vjet apo më shumë duke pasur parasysh që planifikimi i buxhetit është i shpërndarë në disa faza përgjatë vitit parardhës të buxhetit.

- Planifikimi

Planifikimi është një proces burokratik që përfshinë të gjitha strukturat që ushqehen nga buxheti në institucionet publike. Planifikimi ndodh në institucione ndërkohë që procesi rregullohet e monitorohet nga një sërë aktesh ligjore e udhëzimesh apo urdhërash nga Ministria e Financave. Kjo nuk nënkupton përfshirjen apo imponimin e ministrisë së Financave në procesin e hartimit të buxhetit, duke pasur parasysh se edhe tavanet e vendosura prej saj janë orientuese dhe nuk kushtëzojnë planifikimin apo propozimin. Gjatë kësaj faze kryhen përveç propozimeve për buxhet vjetor edhe fazat e parashikimit të buxhetit afatmesëm siç quhen ndryshe edhe Planifikim Buxhetor Afatmesëm - PBA1 dhe PBA2.

- Miratimi

Procesi i miratimit nis me dërgimin e projekt buxhetit në Ministrinë e Financave. Më pas Ministria e Financave sipas një kalendarit të përcaktuar qartë ia dërgon Këshillit të Ministrave i cili e dërgon për


miratim në Kuvend. Buxheti diskutohet në komisionet përkatëse të Kuvendit, Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin e Ekonomisë dhe më pas miratohet në seancë plenare në dy faza, njëherë miratim në parim dhe njëherë nen për nen.

- Zbatimi

Zbatimi i buxhetit shoqërohet me një numër udhëzimesh për zbatimin e tij ku përcaktohen rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të përmblushin nëpunësit autorizues dhe zbatues, të të gjitha niveleve, në procesin e zbatimit të buxhetit. Institucionet raportojnë në Ministrinë e Financave çdo katër muaj (pra tre herë në vit) në lidhje me zbatimin e buxhetit përmes raporteve të monitorimit të buxhetit.


- Kontrolli

Kontrolli i zbatimit të buxhetit është i brendshëm dhe i jashtëm. Kontrolli i brendshëm kryesisht ka vëmendje të shpenzimit dhe mënyrat se si shpenzohen paratë ndërsa kontrolli i jashtëm lidhet me procese më të gjera e qëllime më përfshirëse. Në institucionet e drejtësisë kontrolli i brendshëm kryhet nga zyra e auditit ndërsa kontrolli i jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Ndërkaq Kuvendi ushtron kontrollin e tij përmes raportimeve që institucionet bëjnë në Kuvend sipas kërkesave të ligjit por edhe më kërkesë të vet Kuvendit.



Institucionet dhe fazat e procesit buxhetor

1. PLANIFIKIMI (Janar-Gusht)



Janar

Kuadri makroekonomik hartohet nga Ministria e Financave



Shkurt

Ministria e Financave cakton tavanet sipas sektorëve



Korrik

Udhëzimi për përgatitjen e buxhetit deri më 10 Korrik



Qershor

Kabineti miraton strategjinë dhe tavanet



Gusht

Institucionet e Drejtësisë dorëzojnë kërkesat për buxhet



2. MIRATIMI (Shtator-Dhjetor)



Shtator

Ministria e Financave shqyrton kërkesat për buxhet



Shtator-Tetor
Përgatitja e projektbuxhetit



20 Nëntor

Projektbuxheti dërgohet në Kuvend



15 Tetor

Keshilli i Ministrave shqyrton projektbuxhetin



15 Dhjetor

Kuvendi miraton buxhetin



Raportime çdo 4 muaj në Ministrinë e Financave
Monitorim për të siguruar përmbushjen e objektivave



Nga zyrat e auditit
Nga KLSH
Nga Kuvendi

3. ZBATIMI (Gjithë vitin pas miratimit)

4. KONTROLLI (Gjithë vitin)

Çfarë duhet ditur për përgatitjen dhe miratimin e buxhetit të Sistemit të Drejtësisë

- Ministri i Financave, brenda datës 10 korrik të çdo viti buxhetor, nxjerr udhëzimin për përgatitjen e projektbuxhetit për vitin pasardhës nga të gjitha institucionet buxhetore. Ky udhëzim vlen njësoj për të gjitha njësitë e zbatimit të buxhetit të sistemit të Drejtësisë. Në këtë udhëzim përcaktohen politikat që do të ndiqen, kriteret që do të përdoren për përgatitjen e buxhetit, procedurat dhe afatet për t'u respektuar, në paraqitjen e kërkesave për shpenzime nga të gjitha institucionet buxhetore.
- Institucionet buxhetore, brenda datës 1 shtator, duhet të dërgojnë pranë Ministrisë së Financave kërkesat e tyre, sipas udhëzimit. Në bazë të këtyre miniprojektbuxheteve, Ministria e Financave bën analizën në total të nivelit të të ardhurave, të kërkesave për shpenzime, të numrit të të punësuarve në institucionet buxhetore, si dhe propozon rregullimet e nevojshme në varësi të burimeve buxhetore etj.
- Periudha 10 korrik, pas daljes së Udhëzimit të Ministrit të Financave deri më 30 shtator, është periudha e provës për institucionet e sistemit të Drejtësisë, sidomos për KLGJ-në dhe prokuroritë, sidomos ato speciale, pasi lobimi i këtyre institucioneve, mund të bëjë të mundur shtimin e ndjeshëm të fondeve të domosdoshme për institucionet e sistemit të Drejtësisë, që janë fondet për investime themelore (kapitale).
- Pasi është bërë harmonizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjitha institucionet buxhetore, Ministri i Financave harton projektbuxhetin e shtetit dhe e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, brenda muajit tetor. Projektbuxheti shoqërohet nga një analizë nëntëmujore e treguesve të buxhetit për vitin në vazhdim, si dhe nga argumentet për planifikimin e tyre për vitin tjetër fiskal. Në mënyrë të përmbledhur, në Ministrinë e Financave prezantohen tabela me të ardhurat dhe shpenzimet si për vitin e kaluar, për atë në vazhdim dhe ato për vitin e ardhshëm, për të gjitha institucionet buxhetore. Në këto prezantime, janë dhe tabelat në Excel për buxhetin e sistemit të Drejtësisë.
- Pasi studiohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, projektbuxheti dërgohet për diskutim dhe miratim në Kuvend brenda datës 20 nëntor të vitit ushtrimor. Në emër të Këshillit të Ministrave, është Ministri i Financave ai që prezanton projektbuxhetin e shtetit përpara Kuvendit dhe jep shpjegimet e duhura rreth tij.
- Pasi diskutohet në Kuvend dhe bëhen ndryshimet e nevojshme, projektbuxheti miratohet dhe merr formë të prerë. Kjo do të thotë se shuma e parashikuar për shpenzime është kufi maksimal dhe se tejkalimi i këtij kufiri do të bëhet me miratimin e Kuvendit. Edhe në këtë fazë të projektbuxhetit, sërish ekziston mundësia e korrigjimit të shifrave për investimet themelore të sistemit të drejtësisë, si një sprovë ekstreme, me deputetë në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Ekonomisë. Është një mision i vështirë, por jo i pamundur, deri më 20 nëntor.
- Procesi i përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të Shtetit, brenda tij edhe buxhetin e sistemit të Drejtësisë, përfundon me botimin e tij në Fletoren Zyrtare, 15 ditë pas votimit të tij nën per nën në Kuvend.

Roli i medias gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të buxhetit

Sikurse del nga përmbajtja e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit në gjashtë pikat e mësipërme, puna lobuese e magjistratit dhe gazetarit mund të ndihmojë shumë, jo vetëm në kuptimin e procedurave të ngjizjes dhe miratimit të buxhetit të Drejtësisë, por edhe në arritjen e financimit të duhur për nevojat për investime themelore të sistemit.

Duhet theksuar se reforma në nivelin e pagave të magjistratëve të sistemit ka qenë serioze. Sot niveli mesatar i pagës së një magjistrati në Shqipëri është mbi mesataren e rajonit dhe pranë nivelit 70% të mesatares së nivelit të pagave të magjistratëve në vendet e Bashkimit Europian.

Reforma e dytë në buxhetin e sistemit të Drejtësisë, ajo e investimeve themelore të duhura, sapo ka filluar dhe përballlet me sfida shumë të mprehta, të tilla si:

- Ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të anëtarëve të Kuvendit dhe të qeverisë, në domosdoshmërinë e rritjes me herë të fondeve për investime themelore në Drejtësi.
- Ngritjen e nivelit të kuptueshmërisë dhe ndërgjegjësimit të magjistratëve për rolin e tyre në lobimin për më shumë fonde për investime themelore në Drejtësi.
- Ngritjen e nivelit të kuptueshmërisë dhe ndërgjegjësimit të gazetarëve dhe opinionit publik në domosdoshmërinë dhe pjesëmarrjen aktive në lobimin për më shumë fonde për investime themelore në Drejtësi.

Programi i Buxhetit të sistemit të Drejtësisë

Programi i Buxhetit[7]: Në bazë të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të vitit 2008, amenduar në vitin 2017, programi i buxhetit në sistemin e Drejtësisë përbëhet nga tre programe buxhetore. Ato përveç emërimit me fjalë pasqyrohen edhe me një kod pesëshifror.

- Programi buxhetor 0110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program përfshin fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 0110 për vitin 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshi me gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	209,000	24,559	233,559	227,194	97%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	27,500	1,000	28,500	26,072	91%
03	Shpenzime operative	71,700	0	71,700	51,618	72%
04	Shpenzime tranf fam	1,500	3,453	4,953	2,808	57%
05	Investime	15,000	0	15,000	12,788	85%
	Totali	324,700	29,012	353,712	320,480	91%

- Programi buxhetor 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”

Ky program përfshin fondet buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e Drejtësisë. Nga të dhënat e kësaj pasqyre, del që buxheti i mbështetjes për teknologjinë në sistemin e Drejtësisë është realizuar vetëm 40%, ç’ka përbën një këmbanë alarmi për drejtuesit e sistemit, për të këmbëngulur që t’i shkohet deri në fund realizimit të projekteve për teknologjinë e informacionit në drejtësi. Projektet për teknologjinë përfshihen në programin “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë, QTI”, që është pjesë e buxhetit që menaxhohet nga KLGJ.

*Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 01140, viti 2023*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndryshi me gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	10,850	-1,200	9,650	3,666	38%
02	Shpenzime sig. Shoqërore	1,650	0	1,650	508	31%
03	Shpenzime operative	376	1200	1,576	1,055	67%
04	Shpenzime tranf fam	24	100	124	0	
05	Investime	0	0	0	0	
	Totali	12,900	100	13,000	5,229	40%

[7] Pasqyra e shpenzimeve buxhetore për KLGJ për vitin 2023, sipas Raportit Vjetor të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLGJ) për vitin 2023

• Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”

Ky program përfshin fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet. E njëjta formë programi zbatohet edhe për prokuroritë. Me poshte paraqitet pasqyra e shpenzimeve buxhetore për këtë program, sipas raportit vjetor të Keshillit të Lartë të Drejtësisë (KL Gj) për vitin 2023.

Pasqyra
e buxhetit të miratuar, rishikuar dhe realizuar për programin 03310, viti 2023

000 lekë

N r	Emërtimi	Buxheti i miratuar	Ndrryshime gjatë vitit	Buxheti i rishikuar	Realizimi	Realizimi %
01	Shpenzime paga	2,399,700	704,446	3,104,146	3,054,403	98%
02	Shpenzime shoqërore sig.	290,000	25,000	315,000	296,127	94%
03	Shpenzime operative	611,300	68,000	679,300	645,026	95%
04	Shpenzime transfam	8,000	3,200	11,200	4,082	36%
05	Investime	716,000	-344,400	371,600	339,108	91%
	Totali	4,025,000	456,246	4,481,246	4,338,746	97%

Detajimi i buxhetit të Drejtësisë

Le të shohim më në detaje programin e buxhetit të Gjyqësorit. Shpenzimet e këtij programi përbëhen nga:


- 1.shpenzimet për pagat;
- 2.shpenzimet për sigurimet shoqërore;
- 3.shpenzimet operative, ku hyjnë shpenzime të blerjeve të vogla apo të tjera si karburanti, kancelari, etj.;
- 4.shpenzimet për transfertat familjare; dhe
- 5.shpenzimet për investime.

Shpenzimet ndahen në zëra ose artikuj. Ato ndiqen gjithnjë nga një kod me tre shifra.

Pasqyra
e fondeve buxhetore, për sistemin gjyqësor, (KL Gj-QTL Gjykatat), viti buxhetor 2023, sipas programeve

000 lekë

Gr	Kodi	Emërtimi i programit	Shp. Paga (600)	Shp. Sig. shoqërore (601)	Shp. Operativ (602)	Shp. trans (606)	Shpenz me kapitale (230+231)	Totali fondeve buxhetore
29	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	209,000	27,500	71,700	1,500	15,000	324,700
29	01140	Mbledhërtje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	10,830	1,650	376	34	-	12,990
29	03310	Buxheti Gjyqësor	2,399,700	290,000	611,300	8,000	716,000	4,025,000
29		Këshilli i Lartë Gjyqësor	2,619,530	319,150	683,376	9,524	731,600	4,362,600



Shpenzime personeli

Artikulli 600
"Pagat"

Shpenzimet operative

Artikulli 601
"Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore"

Shpenzimet kapitale


Artikulli 602
"Shpenzime administrative, transport, blerje karburanti, energji elektrike, etj."

Shpenzimet për transferata për buxhetet familjare dhe individët

Artikulli 230
"Kapitale të patrupëzuara"

Artikulli 231
"Kapitale të trupëzuara"

Artikulli 606
"Dhënie të ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie, pensione etj."




Në sistemin e Drejtësisë, shpenzimet kryesore janë ato për pagat, ose artikulli 600 “Pagat” dhe artikulli 601 “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”. Këto shpenzime, në gjuhën e financës, quhen ndryshe edhe “**Shpenzime personeli**”. Së bashku, këto shpenzime zënë mbi 75% të buxhetit të gjyqësorit.

Zëri i dytë më i rëndësishëm në shpenzimet e Drejtësisë janë “**Shpenzimet operative**” (artikulli 602 në klasifikimin e shpenzimeve buxhetore gjendet edhe me titullin ndryshe “Mallra dhe shpenzime të tjera”). Në këtë fond hyjnë shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të institucionit, për energji elektrike, shpenzime administrative, transport, blerje karburanti, etj. Këto shpenzime zënë mbi 15% të buxhetit të gjyqësorit dhe rreth 18% të buxhetit faktik të Drejtësisë për vitin 2023.

Zëri i tretë më i rëndësishëm në shpenzimet e gjyqësorit në vitin 2023 ishin “**Shpenzimet kapitale**”, ose Investimet, artikulli 230 “Kapitale të trupëzuara (investime për shërbime, si programe IT, etj.)” dhe artikulli 231 “Kapitale të trupëzuara (investime për ndërtesa, rikonstruksione zyresh, etj.)”. Këto shpenzime zënë rreth 8.2% të buxhetit faktik të Gjyqësorit dhe 9% të buxhetit faktik të Drejtësisë për 2023. Shumë pak për nevojat urgjente dhe të domosdoshme të Drejtësisë për investime.

Zëri i katërt i shpenzimeve buxhetore në gjyqësor janë “**Shpenzimet për transferta për buxhetet familjare dhe individët**” (artikulli 606). Këto janë shpenzime që përdoren kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare, apo për dhënie të ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie dhe raste të tjera (sëmundje dhe pension pleqërie), etj. Edhe pse shifra e këtij shpenzimi është modeste, ky artikull është i rëndësishëm, pasi tregon fytyrën njerëzore të buxhetit për Drejtësinë.

Buxheti faktik i Drejtësisë për vitin 2023



Hartimi i Programit të Buxhetit

Afatmesëm për Drejtësinë

Gjatë hartimit të Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA) për 3 vite, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit bën thirrje për konsultime me gjyqësorin (magjistratët), por edhe grupet e tjera të interesit, si avokatët, organizatat e shoqërisë civile, gazetarët, etj. Nga praktika, kësaj thirrjeje i janë përgjigjur vetëm një numër shumë i kufizuar organizatash të shoqërisë civile dhe gazetarësh. Prokuroritë nuk e kanë bërë këtë thirrje publike.

Hartimi i buxhetit të KLGJ, buxhetit të gjykatave dhe prokurorive bëhet në bazë të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i vitit 2008, i amenduar më vonë, si dhe bazuar në Udhëzimin Zbatues të Buxhetit për vitin ushtrimor nga Ministria e Financave.

Në bazë të këtyre dy dokumenteve, ka një skenar dhe strukturë të qartë të hapave të hartimit të buxhetit, që në momentin e parë në muajin shkurt, e deri sa buxheti vjen për miratim në KLGJ dhe në prokuroritë në vjeshtë.

GMS (Grupi i Menaxhimit Strategjik) i KLGJ-së, i cili, sipas Udhëzimit Nr. 22 të Ministrisë së Financave, është struktura kryesore e monitorimit të zbatimit rigoroz të buxhetit në një institucion të madh buxhetor, mbledhet jo më pak se 3 herë në vit. Në vitin 2024, në 4 muajt e parë të tij, ky grup është mbledhur 4 herë.

KLGJ realizon: - konsultime të përditshme me subjektet për të gjitha çështjet, -mbledhje çdo muaj për të diskutuar për buxhetin, -unifikimin e procedurave për të gjitha gjykatat, -model të përbashkët relacioni. Në fazën e parë të propozimit të Programit të Buxhetit Afatmesëm, ka një tavan përgatitor të shifrave të buxhetit, të pesë artikujve të shpenzimeve të shpjeguara më lart, ndërsa në fazën e dytë ka një tavan përfundimtar, real. Pra, këto janë shifra përfundimtare, që duhet të konfirmohen nga Ministria e Financave.

Shifrat, tavanet që përcaktohen nga Ministria e Financave mbështeten nga realizimi i buxhetit në vitin e kaluar, si dhe realizimi 2-mujor i vitit në vazhdim.

Buxheti i Shtetit i miratuar nga Kuvendi (ku përfshihet dhe buxheti i sistemit të Drejtësisë), zakonisht rikthehet në Ministrinë e Financave më 26 dhjetor. Nga kjo datë, disbursimi i tij për KLGJ-në dhe prokuroritë bëhet zakonisht shumë shpejt. Në vitin 2023, u çelën me vonesë investimet.

Për vitin 2024, shpenzimet e personelit (pagat dhe sigurimet shoqërore) zunë peshën kryesore të buxhetit të miratuar në sistemin e Drejtësisë, në masën 66%, ndërsa investimet ishin ende shumë më të ulëta se nevojat reale që ka sistemi, në masën 49% të kërkesave të paraqitura. Për vitin buxhetor 2024, buxheti i miratuar dhe i realizuar në 96%, për sistemin gjyqësor, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, ishte në vlerën **4,967,459 mijë lekë**, ose gati **50 milionë euro**.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit

Monitorimi i zbatimit të buxhetit sipas ligjit për "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 (i ndryshuar) për "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" parashikon proceset e monitorimit të menaxhimit të buxhetit. Në nenet 18, 19, 20 të këtij ligji përshkruhet hierarkia e zbatimit të buxhetit brenda institucioneve të qeverisjes qendrore ku përfshihen edhe institucionet e drejtësisë.

Në nenin 18 përshkruhet '**Nëpunësi i parë autorizues**' i cili është Sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për financat, në këtë rast Ministria e Financave. Nëpunësi i parë autorizues paraqet në komisionin përkatës parlamentar raporte periodike, pasqyra financiare dhe raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në nenin 19 përcaktohet '**Nëpunësi autorizues**' dhe kompetencat e tij. Nëpunës autorizues në njësitë e qeverisjes qendrore është punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil. Në institucionet gjyqësore ky nëpunës është Sekretari i Përgjithshëm. Nëpunësi autorizues është përgjegjës për menaxhimin financiar në njësinë e qeverisjes së përgjithshme. Përgjegjësitë për menaxhimin financiar përfshijnë, por nuk kufizohen, në: a) përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, kontabilitetin, raportimin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme; b) sigurimin e përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike. Nëpunësi autorizues i njërive të qeverisjes qendrore dhe i njërive të fondeve speciale të qeverisjes qendrore raporton dhe përgjigjet përpara nëpunësit të parë autorizues për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes qendrore, me miratim të titullarit, cakton punonjës të administratës publike si **nëpunës autorizues të nivelit të dytë** në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes qendrore.

Në nenin 20 të këtij ligji përcaktohet profili i '**Nëpunësit zbatues**' i cili është punonjës i administratës publike, i nivelit të lartë, të shërbimit civil të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare. Nëpunësi autorizues i njërive të qeverisjes së përgjithshme udhëzon dhe informon nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të varësisë dhe garanton zbatimin e udhëzimeve të dhëna prej tij nga nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese që ka në juridiksion.

Në nenin 68 përcaktohen funksionet e auditit të brendshëm i cili siguron, në mënyrë të arsyeshme, që burimet publike, në dispozicion të njësisë së qeverisjes së përgjithshme: a) janë shpenzuar, dokumentuar dhe raportuar, në bazë të një informacioni të besueshëm dhe të shpejtë; b) kanë kontribuar maksimalisht në arritjen e qëllimeve dhe të objektivave të politikës; c) janë përdorur në mënyrë efçente, ekonomike dhe efektive; ç) nuk janë vjedhur, keqpërdorur apo shpërdoruar.

Në nenin 68 të këtij ligji sigurohet edhe audit i jashtëm ku thuhet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme i nënshtrohen, pa asnjë lloj kufizimi, auditimit të jashtëm, i cili kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit sipas Udhëzimit nr. 22, 2016 i Ministrisë së Financave (ndryshuar me udhëzimin nr.14, 30.05.2023)

Institucionet e drejtësisë ashtu si gjithë njësitë e qeverisjes qendrore kanë dy kanale përmes të cilave komunikohet për buxhetin. Njëri është ai i raportimit sipas hierarkisë nga Nëpunësi Zbatues deri tek Nëpunësi i Parë Autorizues; ndërsa tjetri realizon procesin e monitorimit dhe përmirësimit përmes disa hallkave të ngritura në institucion që janë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve (EMP). Që të dy këto kanale janë të kryqëzuara njëra me tjetrën.

Nëpunësi Autorizues, ka përgjegjësi të raportojë tek Nëpunësi i Parë Autorizues në mënyrë periodike çdo katër muaj, por jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar. Ndërkaq Nëpunësi Zbatues raporton tek Nëpunësi Autorizues si dhe drejtuesve të programeve, informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit.

Ndërsa funksionimi i hallkave të mësipërme GMS dhe EMP kryhet si në vijim: GMS shqyrton raportet e monitorimit. Drejtuesi i GMS është titullari i institucionit, ndërkohë që anëtarë të GMS janë edhe drejtuesit kryesorë në institucionit.

EMP përgatit raportet e monitorimit sipas formateve, afateve dhe standardeve të kërkuara nga Ministria e Financave. Anëtarët e EMP janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të monitorimit. Raporti për GMS duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me performancën e çdo produkti, mospërputhjet, veprimet korrigjuese, rekomandimet.

Procesi formal i raportimit mbi performancën kërkon përgatitjen e tre raporteve periodike të monitorimit në vit, mbi performancën e produkteve për secilin program. Raportet e katërmujorit dhe tetëmuorit duhet të dorëzohen tek njësia përgjegjëse për monitorimin, në Ministrinë e Financave deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit dhe konkretisht deri më 30 maj; 30 shtator ndërsa raportin vjetor deri në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm.

Menjëherë pas përfundimit të katërmujorit, **Drejtuesi i EMP (DEMP)** duhet të organizojë një mbledhje të EMP për të rishikuar të dhënat mbi performancën gjatë katërmujorit paraardhës. DEMP duhet të sigurojë të dhëna të domosdoshme mbi performancën për çdo objektiv apo produktet përkatëse, me qëllim që t'i paraqesë ato në mbledhjen e EMP-së.

Mbështetur në të dhënat e disponueshme, **EMP** shqyrton nëse ka mospërputhje ndërmjet planit për katërmujorin dhe performancës së tij. EMP duhet të rishikojë çdo mospërputhje, të diskutojë, konsultojë stafin teknik kur është e nevojshme dhe të shpjegojë arsyet e mospërputhjeve dhe veprimet që duhet të ndërmerren ose janë ndërmarrë për të zgjidhur situatën.

Kur EMP ka sqaruar arsyet e mospërputhjeve dhe ka përcaktuar masat korrigjuese që do të ndërmerren, DEMP duhet të përgatisë dhe të firmosë një raport për GMS-në. **GMS** mblidhet çdo katërmujor për ta miratuar raportin.

Anekset



Aneksi 1

paraqet shpenzimet sipas programeve (paga, sigurime, të tjera), krahasim i planit fillestar, rishikimit, realizimit dhe diferencave

Aneksi 2

paraqet raportin e shpenzimeve të programit sipas shpenzimeve të kryera

Aneksi 3

paraqet raportin përmblidhës të realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit

Aneksi 4

shpreh raportin e realizimit të objektivave të politikës së programit

Raporti katërmujor i monitorimit duhet të përmbajë 4 Aneksa, ku të dhënat janë të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin e thesarit, relacion shpjegues për çdo program, si edhe një relacion përmblidhës për institucionin.

Hallkat e raportimit (Kanali I)



Nëpunësi Zbatues



raporton informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit



Nëpunësi Autorizues

raporton në mënyrë periodike çdo 4 muaj (jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës) raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare



Nëpunësi i Parë Autorizues



paraqet në komisionin përkatës parlamentar raporte periodike, pasqyra financiare dhe raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë

Hallkat e monitorimit (Kanali II)

 Ekipi i Menaxhimit të Programeve (EMP) 

përgatit raportet e monitorimit sipas formateve, afateve dhe standardeve të kërkuara nga Ministria e Financave

shqyrton raportet e monitorimit, që duhet të përmbajnë të dhëna në lidhje me performancën e çdo produkti, mospërputhjet, veprimet korrigjuese, rekomandimet

 Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) 



3 raporte periodike të monitorimit në vit, mbi performancën e produkteve për secilin program



dërgohen në njësinë përgjegjëse për monitorimin, në Ministrinë e Financave

 deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit

 **30 maj;**
30 shtator;
fund të muajit
shkurt të vitit
të ardhshëm



Pas çdo katërmujori, **EMP** shqyrton performancën dhe identifikon mospërputhjet me planin, duke propozuar masa korrigjuese.

Drejtuesi i EMP-së përgatit raportin për **GMS-në**, e cila e miraton në mbledhjen e saj katërmujore.



RAST PRAKTIK - Ku gjenden të dhënat financiare për buxhetin e drejtësisë?

Pjesa më e madhe e të dhënave që lidhen me financat e gjyqësorit apo institucioneve të tjera të drejtësisë gjenden tek dritarja “Programi i Transparencës”, i cili është i publikuar në të gjitha faqet e institucioneve qendrore e publike. “Programi i Transparencës” është kërkesë e [ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”](#), neni 7 i tij.

HAPI 1

Vizito faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në www.klgj.al/

Kreu Rreth Nesh Kontakt ANTI CORRUPTION POLICY



Njoftime Dokumentimi i Mbledhjes Plenare Vendime Legjislatiioni Programi i transparences Keshilltari i



MIRËSEVINI NË FAQEN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Për një drejtësi transparente,



Roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor në transparencën e gjyqësorit

Institucionet e drejtësisë kanë instaluar Programin eTransparencës dhe në bazë të lgjit “Për të drejtën e Informimit” duhet të publikojnë dokumentet kryesore për institucionin. Ndërkaq Udhëzimi Nr.22 i Ministrisë së Financave për monitorimin e buxhetit kërkon nga institucionet qendrore publike publikimin në faqen online të raporteve të monitorimit të buxhetit, 4 mujore, 8 mujore dhe vjetore.

Edhe në Nenin 91 ‘Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun’ të lgjit 115/2016 ‘Për organizimin e institucioneve të drejtësisë’ theksohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun.

Në këtë kuadër, Këshilli realizon detyrimet e mëposhtme:

- krijon, zhvillon, dhe mirëmban **një portal elektronik në internet**, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik;
- bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t’i lejohej të publikojë të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;
- merr masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;
- miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesit standard të shtypit.

2. Këshilli cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.

4. Shkolla e Magjistraturës ofron trajnim për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët për mediat, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen bazuar në parimet e së drejtës për qasje në informacion, duke pasur parasysh mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë.

KLJGJ ka hartuar dhe miratuar “Udhëzuesin standard të marrëdhënies së gjykatave me publikun dhe median”.

Sipas këtij udhëzuesi Gjyqtari i caktuar për marrëdhënien me publikun dhe median ushtron funksionet e mëposhtme:


- Ushtron veprimtarinë e shërbimit me publikun dhe median nëpërmjet nëpunësit të marrëdhënies me publikun dhe median;
- Koordinon veprimtarinë me gjyqtarin e çështjes në rastet me interes të veçantë publik dhe Kryetarin e gjykatës;
- Shërben si zëdhënës për gjykatën në rastet e çështjeve me rëndësi të veçantë për publikun dhe median duke shpjeguar procedurat e ndjekura nga gjykata, pa dhënë komente mbi zgjidhjen e çështjes;
- Përgatit projektdeklaratën publike dhe bashkëpunon me anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjegjës për marrëdhënien e publikut dhe median për mbajtjen e qëndrimeve publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë ose të gjykatës kur cenohen funksionet e tyre;
- Bashkëpunon me gjyqtarët e tjerë të medias, kryetarët e gjykatave dhe kancelarët për unifikimin e mënyrave dhe formave të dhënies së informacionit;
- Udhëzon nëpunësin e marrëdhënies me publikun dhe median për procedurat e dhënies së informacionit apo të komunikimit me mediat, nëse nuk ushtrohen drejtpërdrejt prej tij/saj;
- Jep intervista në media apo konferenca për shtyp për informimin e publikut dhe medias për çështje me interes të veçantë publik, ose në rast të konstatimit të informacioneve të pasakta të publikuara në media;
- Organizon takime e prezantime periodike me gazetarët, me qëllim vendosjen e komunikimit të përditshëm.

2. Kur gjyqtari i medias është njëkohësisht gjyqtari i çështjes me interes të veçantë publik, bashkëpunon me anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjegjës për publikun dhe median për komunikimin publik të çështjes.

Pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dyfishuar numrin e gjyqtarëve të medias. Për vitin 2023 ishin caktuar 17 gjyqtarë të medias që mbulojnë gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe posaçëm, nga 8 të tillë që ishin në 2022.

HAPI 2

Kliko dritaren “Programi i
Transparencës” në menunë kryesore



**Në përputhje me këtë Program
Transparence të miratuar,
institucioni vendos në
dispozicion të publikut, në
faqen e tij të internetit këto
kategori të informacionit:**





Programi i Transparencës



Rreth autoritetit

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë
mbi AP

Shërbimet që ofrohen nga AP

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Programi i Transparencës

Kreu Rreth Nesh Kontakt ANTI CORRUPTION I

Njoftime Dokumentimi i Mbledhjes Plenare Vendime Legjislacioni Programi i tran

Programi i Transparencës
Hyrje



Kuadri ligjor rregullator
Tekstet e plota

E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të
AP

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat
konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime
lidhur me procesin e hartimit të akteve
ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me
ushtrimin e funksioneve të AP

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe
format e dokumenteve

Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh
dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga
AP

HAPI 3

Pasi klikoni tek dritarja “*Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare*”, ju gjeni:



Buxhetin për disa vite radhazi

Raportet e zbatimit të buxhetit (4-mujore, 8-mujore dhe vjetore)



Të gjitha anekset e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve


Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara 
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset 
- Donacione, sponsorizime 
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara 

HAPI 4

Klikoni në këtë dritare:

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat



dhe do të gjeni:



Të dhëna në lidhje me prokurimet

Regjistrat e parashikimit të prokurimeve dhe
ato të realizimit të prokurimeve



Kreu Rreth Nesh Kontakt ANTI CORRUPTION F

Njoftime Dokumentimi i Mbledhjes Plenare Vendime Legjislacioni Programi i tran

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

Shërbimet që ofrohen nga AP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nëntligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit. Llojet dhe format e dokumenteve

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve) ✓
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik ✓
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik ✓
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme ✓

Programi i Transparencës

Shpesh të dhëna në lidhje me buxhetin gjenden edhe në raporte të tjera të institucioneve të gjyqësorit që janë të hedhura në dritaren:

“Mekanizmat kontrollues dhe monitorues”

“Kuangri ligjor”

ku janë raportet vjetore të institucionet apo të zyrove të ndryshme, rezolutat e Kuvendit, auditimet e KLSH, etj.

Dëshironi përgjigje më të shpejtë?

Mund të konsultoni dritaren *“Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”*

Nëse të dhënat financiare nuk i gjeni dot në asnjë nga rubrikat e Programit të Transparencës, në dritaret e sipërpërmendura, kërkonin në faqen e institucionit tek pjesa ‘Vendime’ apo ‘Njoftime’. Shpesh zyrtarët e komunikimit kanë vështirësi teknike në hedhjen e të dhënave dhe për lehtësi i vendosin materialet dhe informacionet e tilla në sektorë të tjerë të faqes zyrtare të institucionit.

Nëse nuk keni arritur asgjë përmes faqes online të institucionit atëherë një mundësi tjetër është realizimi i kërkesës për informacion, si e drejtë e çdo qytetari bazuar në ligjin për të Drejtën e Informimit Nr. 119/2014, i ndryshuar.

Sipas Nenit 11 të këtij ligji: Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuar dhe nënshkrimin e tij.

Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuar;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuar gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Neni 15 i ligji përcakton afatet për të marrë përgjigje pas kërkesës për informim:

Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme: a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze; b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit; c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës. Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuar.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

Nga testimi që qTIL ka bërë me një pjesë të mirë të institucioneve të drejtësisë, përgjigje janë dhënë në kohë dhe pothuajse të plota.

